

**“Trajnim për stafin e Qendrës Kombëtare Pritëse për Azilkërkuesit dhe të Qendrave të Përkohshme në qasjet pro-aktive për identifikimin e kontrabandimit dhe trafikimit të personave ne flukset migratore të përziëra”**

Zyra e Koordinatorit Kombëtar për Çështje të Luftës kundër Trafikimit të Personave në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit (Departamenti për Kufirin dhe Migracionin), Drejtorinë e Azilit dhe Shtetësisë, si dhe Organizatën Ndërkombëtare për Migracionin (IOM), **në datat 24 dhe 25 prill, në Tiranë**, zhvilluan dy trajnime kombëtare në zbatim të projektit “Lufta kundër Kontrabandimit të Migrantëve përgjatë Rrugës Bregdetare të Ballkanit Perëndimor”.

Gjatë trajnimit u diskutua mbi situatën aktuale të flukseve mikse migratore, profilet dhe statistikën, regjistrimin, përzgjedhjen dhe identifikimin e referimin e kategorive të cenueshme; Referimin e personave vulnerabël (përfshirë të miturit e pashoqëruar dhe viktimat e mundshme të trafikimit në flukset migratore), sipas PSV-ve të miratuara me VKM nr. 499 datë 29.08 2018, roli i Autoritetit Përgjegjës dhe referimi tek shërbimet; Sfidat në identifikim dhe referim të kategorive vulnerabil përfshirë të miturit e pashoqëruar dhe viktimat e mundshme të trafikimit në flukset migratore, si dhe shërbimet për viktimat e trafikimit të identifikuar në flukset migratore.

Në trajnim morën pjesë rreth 40 persona nga stafi Qendrës Kombëtare Pritëse për Azilkërkuesit dhe të Qendrave të Përkohshme. Këto trajnime do të kontribuojnë në qasjet pro-aktive për identifikimin e rasteve të kontrabandimit dhe të trafikimit të personave në flukset migratore të përziëra dhe në rritjen e bashkëpunimit rajonal midis Shqipërisë, Bosnjës, Hercegovinës dhe Mali të Zi si dhe rritjen e kapaciteteve të autoriteteve ligj zbatuese dhe gjyqësorit për të kapur, hetuar dhe ndjekur penalisht rastet e kontrabandimit të migrantëve dhe për të mbrojtur migrantët përgjatë rrugës bregdetare të Ballkanit Perëndimor.